



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E AUDITIMIT

AKT KONSTATIMI

I mbajtur sot më datë 27.12.2022 në zbatim të shkresës nr. 20778 prot, datë 10.11.2022, ndërmjet Grupit të Auditimit të ngritur për kqyerjen e zbatimit të rekomandimeve, të lëna në Auditimin e mëparshëm në Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave.

Në zbatim të pikës iv, të germës “ç”, të nenit 14 të ligjit nr.114 datë 06.11.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. të germës “ç” të pikës 10, të Urdhërit të Ministrit Financave dhe Ekonomisë nr. 14, datë 13.02.2017 “Për kqyerjen e zbatimit të rekomandimeve të auditimit të brendshëm”, z. Bajram KURTI dhe znj. Nensi XHANI kanë kryer kqyerjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm në Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave. Plani i veprimit është përcjellë Drejtorisë së Auditimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 14303/5 prot, datë 24.11.2021.

Statusi i zbatimit të rekomandimeve të pranuar rezulton si më poshtë :

Rekomandimi nr.1: Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave të kërkojë që të gjithë punonjësit e rinj të aplikojnë në trajnimet e organizuara nga ASPA për punonjësit e administratës publike.

Statusi: Rekomandimi është realizuar

Koment: Në periudhën shtator 2021 e në vijim gjatë vitit 2022, punonjësit e rinj, por edhe punonjës të tjerë kanë aplikuar dhe kanë marrë pjesë në rreth 38 trajnime të organizuar nga ASPA por dhe nga institucione dhe organizata të tjera brenda dhe jashtë vendit.

Rekomandimi nr.2: Përmbauesit gjyqësor ti nënshtrohen analizës së riskut dhe më pas të planifikohen inspektive periodike.

Statusi: Rekomandimi është realizuar

Koment: Sektori i Analizës dhe Përputhshmërisë ka realizuar procesin e vlerësimit të riskut për përmbauesit gjyqësor. Për vitin 2022, kjo drejtori në subjektet “Përmbaues gjyqësor” ka realizuar 2 inspektive në vend, 12 inspektive në distancë dhe 4 inspektive në distancë janë proces realizimi.

Rekomandimi nr. 3: Dosjet e procedurës së shqyrtimit të kundravajtjes administrative të inventarizohen dhe arkivohen sipas normave tekniko profesionale, si dhe dosjet e inspektimit të shoqërohen me listën e dokumentacionit.

Statusi: Rekomandimi është realizuar.

Koment: Drejtoria e Analizës dhe Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit ka hartuar format tip për inventarizimin dhe arkivimin e dokumentave të dosjeve të kundravajtjeve administrative. Të gjithë dosjet e kundravajtjeve administrative janë inventarizuar dhe arkivuar në përputhje me kërkesat ligjore sipas formatit të miratuar.

Rekomandimi nr. 4: Në aktet e inspektimit të referohet afati i zbatimit të rekomandimeve të lëna bazuar në nivelin e riskut dhe të kërkohet raportimi për përmbushjen e tyre.

Statusi: Rekomandimi është realizuar.

Koment: Drejtoria e Analizës dhe Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit u ka lënë detyrë të gjithë grupeve të inspektimit që në aktin e inspektimit të dokumentohet afati i zbatimit të rekomandimeve dhe detyrave të lëna për subjektin. Nga verifikimi i 3 inspektimeve të muajit Qershor 2022 rezultoi se për rekomandimet e lëna grupi i inspektimit ka referuar afatin e realizimit të tyre.

Rekomandimi nr. 5: DPPPP-ja të përcaktojë afate për procedurat e shqyrtimit të raporteve të vetëkontrollit.

Statusi: Rekomandimi është realizuar.

Koment: Drejtoria e Analizës dhe Përputhshmërisë dhe Teknologjisë së Informacionit në manualin e rishikuar të vitit 2022 ka përcaktuar afat 45 ditë për shqyrtimin e informacionit që subjektet paraqesin në funksion të raporteve të vetkontrollit.

Rekomandimi nr.6: DPPPP, të analizoje dhe të ndjekë të gjitha rrugët ligjore për arkëtimin apo fshirjen e detyrimeve pa shpresë arkëtimi.

Statusi: Rekomandimi është realizuar.

Koment: Drejtoria Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë në bashkëpunim me Sektorin e Financës kanë analizuar situatën e detyrimeve debitore për gjokat e pa arkëtuara dhe me memo nr. 905, datë 30.06.2022 ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm mbi situatën dhe masat që ka marrë për saktësimin e detyrimeve pa shpresë arkëtimi.

Në vijim kjo Drejtori me shkresat nr. 1272, 1273 dhe 1274, datë 30.08.2022 i ka kërkuar Gjykatës Administrative të shkallës së parë Tiranë, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Lartë Tiranë paisjen me vendime të formës së prerë për 27 subjekte. Deri më 30.11.2022, kjo drejtori ka arritur të sigurojë vendime të formës së prerë për 15 subjekte dhe vazhdon procedurat për sigurimin e vendimeve të tjera. Nga 15 vendime të formës së prerë ka rezultuar se 8 prej tyre me vlerë 14,025 mijë lekë janë në favor të subjekteve dhe nuk janë paraqitur për shkarkimin e

detyrimin nga kontabiliteti. Lidhur me rezultatet e këtij planveprimi për ndjekjen e detyrimeve debitore, Drejtoria Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë me memo 905/2, datë 02.12.2022 ka informuar Drejtorin e Përgjithshëm i cili ka kërkuar të vazhdojë ndjekja me prioritet duka zbatuar të gjithë procedurat.

Konkluzione mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve nga njësia e audituar.



Grupi i auditimit arrin në konkluzionin se: nga 6 rekomandime të pranura gjithësej, nga monitorimi rezultojnë me statusin "Realizuar" 6 rekomandime.

Grupi i auditimit falenderon me këtë rast subjektin e audituar për bashkëpunimin.

Për grupin e auditimit

Bajram KURTI

Nensi XHANI

Për Drejtorinë e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave

DREJTORI

Ervin KOÇI

